

DOKUMENTE TË RËNDËSISHME PËR EMIGRACIONIN SHQIPTAR NË SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS

**(Teuta S. Rizaj dhe Gazmend Rizaj, Nga thesari historik e kulturor i
Fan S. Nolit - Shkresa, Memorandume, Raporte Diplomatike dhe
Korrespondencë 1927-1946, Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri” -
Prishtinë, 2023, 256 f.)**

Botimi i dokumenteve historike që ndriçojnë të kaluarën e popullit shqiptar, është thesar i çmuar për historiografinë tonë. Ai përbën një zhanër të veçantë të politikës dhe veprimtarisë botuese të Institutit të Historisë.

Libri i titulluar “*Nga thesari historik e kulturor i Fan S. Nolit – Shkresa, Memorandume, Raporte Diplomatike dhe Korrespondencë (ndërmjet viteve) 1927-1946*”, i autorëve profesoreshë Teuta Rizaj dhe profesor Gazmend Rizaj, është përmbledhje prej 73 dokumentesh, që përfshinë një periudhë interesante dhe dramatike të historisë shqiptare të çerekut të dytë të gjysmës së parë të shek. XX.

Fan S. Noli, në kontekstin e jetës dhe veprimtarisë politike, diplomatike, intelektuale, shoqërore e kulturore, ka zgjuar interesim të studiuesit e fushave të ndryshme. Në këtë kuadër, dokumentet e prezantuara në këtë libër i takojnë Arkivit të Kishës Ortodokse Shqiptare në Boston, Massachusetts të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Autorët e kanë parë të arsyeshme që strukturën e kësaj përmbledhjeje me dokumente ta ndërtojnë brenda përmbajtjes, disa fjalëve për autorët, parathënies, hyrjes, pesë kapitujve dhe treguesit të emrave. Ata kanë zgjedhur dhe përgatitur me kujdes dokumente të rëndësishme, për t’i publikuar në shërbim të historiografisë shqiptare dhe shkencave të tjera shoqërore. Dokumentet janë paraqitur në përputhje me kriterin kronologjik e tematik, në shërbim të pasqyrit sa më të qartë të ngjarjeve, pikëpamjeve, qëndrimeve e synimeve, të cilat përshkuan

jetën dhe veprimtarinë e Fan S. Nolit dhe njëkohësisht zhvillimet në kuadrin e historisë shqiptare të viteve 1927-1946, të paraqitur në kapitujt si:

“Rikthimi i pakthim i Fan S. Nolit në SHBA (1927-1939)”, “Promovimi i njohjes ndërkombëtare të Pavarësisë së Shqipërisë dhe vdekja e Faik Konicës (1942)”, “Kërkesat për njohjen zyrtare të Qeverisë Shqiptare në Mërgim dhe sigurimin e integritetit territorial të Shqipërisë (1943)”, “Shqyrtimi i ndarjes së shqiptarëve në grupe politike dhe ushtarake dhe vendimet përfundimtare të aleatëve mbi përkrahjen e shtetit shqiptar (1944)” dhe “Çështja e njohjes së Qeverisë së Enver Hoxhës dhe anëtarësimit të Shqipërisë në Kombet e Bashkuara (1945-1946)”.

Në kapitullin e parë “**Rikthimi i pakthim i Fan S. Nolit në SHBA (1927-1939)**”, paraqiten këto dokumente: Letër nga Raymond Wilkins drejtuar Nolit; Letër nga Hamilton Fish Armstrong drejtuar Nolit; Dy telegrame mbi çështjen e emigrimit të Nolit; Telegram nga Noli drejtuar Hamilton Holt; Letër nga Kisha e Vjetër Katolike në Amerikë drejtuar Harry E. Hull; Letër nga Kisha e Vjetër Katolike në Amerikë drejtuar Nolit; Letër nga Kisha e Vjetër Katolike në Amerikë drejtuar Nolit; Letër nga Hamilton Holt, Rollins College, drejtuar Nolit; Shkresë nga Komiteti Qendror i Epirotëve Verior.

Në kapitullin e dytë “**Promovimi i njohjes ndërkombëtare të Pavarësisë së Shqipërisë dhe vdekja e Faik Konicës (1942)**”, shpalosen këto dokumente: Raport nga Komiteti Ballkanik Londër (korrik 1942); Letër nga Zyra e Shërbimeve Strategjike Uashington drejtuar Nolit; Letër nga Zyra e Shërbimeve Strategjike Uashington drejtuar Nolit; Letër nga Zyra e Shërbimeve Strategjike Uashington drejtuar Nolit; Telegram nga Noli drejtuar Sekretarit të Shtetit Cordell Hull; Letër nga Kisha Ortodokse Shqiptare në Amerikë drejtuar Zv. Sekretarit të Shtetit Sumner Welles; Letër nga Noli drejtuar Anton Logorecit; Telegram nga Federata Panshqiptare e Amerikës “Vatra” drejtuar 3 sekretarëve të shtetit, SHBA, MB dhe BRSS; Telegram nga Vatra, Dega e Weirton-it, drejtuar Nolit; Fjalimi i Nolit me rastin e varrimit të Faik Konicës; Letër nga Noli drejtuar Sekretarit të Shtetit Cordell Hull; Letër nga Legata e Zvicrës drejtuar Nolit.

Në kapitullin e tretë “**Kërkesat për njohjen zyrtare të Qeverisë Shqiptare në Mërgim dhe sigurimin e integritetit territorial të Shqipërisë (1943)**”, autorët kanë përzgjedhur këto dokumente: Letër nga Departamenti

Amerikan i Shtetit, Divizioni për Çështjet Evropiane, drejtuar Nolit; Letër nga Noli drejtuar Sekretarit të Shtetit Cordell Hull; Letër nga Zyra e Shërbimeve Strategjike drejtuar Divizionit për Çështjet Evropiane; Letër nga Divizioni për Çështjet Evropiane drejtuar Nolit; Letër nga Noli drejtuar Sekretarit të Shtetit Cordell Hull; Shkresë [një pasqyrë gjithëpërfshirëse e Shqipërisë] nga Konsullata e Përgjithshme Amerikane në Stamboll; Letër nga Ambasada Britanike në SHBA drejtuar Peter V. Kolonjës; Letër nga Tajar Zavalani drejtuar redaktorit të “The Central European Observer”; Letër nga Noli drejtuar Tajar Zavalanit; Letër nga Noli drejtuar Sotir Martinut; Dy telegrame nga Tajar Zavalani drejtuar Nolit; Letër nga Ndihma Luftarake Ruse, Inc. drejtuar Nolit; Memorandum “Problemi i Qeverisë së Lirë Shqiptare” nga Zyra e Shërbimeve Strategjike, Dega e Kombësive të Huaja; Letër nga Zyra e Informatave Luftarake Uashington drejtuar Nolit; Deklaratë e Nolit dhënë gazetës “The Daily News”; Letër nga Nelo Drizari, Zyra e Informatave Luftarake Uashington, drejtuar Nolit; Letër nga Kongresisti Christian A. Herter drejtuar Nolit; Letër nga Mary Edith Durham drejtuar Nolit; Memorandum i Bisedës “Gjendja e Brendshme në Shqipëri” nga Zyra e Shërbimeve Strategjike dhe Divizioni për Çështjet Evropiane; Letër nga Mary Edith Durham drejtuar Nolit; Telegram nga Ambasadori i SHBA-së në Londër drejtuar Sekretarit të Shtetit në Uashington; Telegram nga Nelo Drizari drejtuar Nolit; Telegram nga Nelo Drizari drejtuar Nolit; Letër nga Mary Edith Durham drejtuar Nolit.

Në kapitullin e katërt “**Shqyrtimi i ndarjes së shqiptarëve në grupe politike dhe ushtarake dhe vendimet përfundimtare të aleatëve mbi përkrahjen e shtetit shqiptar (1944)**”, autorët prezantojnë këto dokumente: Letër nga Nënkonsulli Amerikan në Stamboll drejtuar Sekretarit të Shtetit në Uashington lidhur me Raportin mbi Shqipërinë nga Asim[e] Jakova; Shkresë No. 2210 (R- 2054), Raporti i Asim[e] Jakovës, Konsullata e Përgjithshme Amerikane në Stamboll; Letër nga Instituti Ndërkombëtar i Bostonit drejtuar Nolit; Letër nga Stefan Pete, Kryqi i Kuq Amerikan, Egjipt, drejtuar Nolit; Telegram nga Ambasadori i SHBA-së në Londër drejtuar Sekretarit të Shtetit në Uashington; Letër nga Mary Edith Durham drejtuar Nolit; Shkresë, “Shqipëria nën Okupimin Gjerman” nga Konsullata e Përgjithshme Amerikane Stamboll; Letër nga Mary Edith Durham drejtuar Nolit; Letër nga Sekretari i Punëve të Brendshme të Ambasadës Amerikane, Kairo, drejtuar

Departamentit të Shtetit, Uashington, lidhur me raportin “Gjendja në Shqipëri”; Shkresë “Gjendja në Shqipëri” nga R. H. Markham, Zyra për Informata Luftarake (OWI), dërguar Departamentit të Shteti; Letër nga Konstandin Tashko drejtuar Nolit; Letër nga Matt L. Mydin, Biblioteka e Kongresit Uashington, drejtuar Nolit; Rezyme analitike e Qarkores së Zyrës së Komitetit Qendror të PKSË nga Departamenti i Shtetit Divizioni për Çështjet e Evropës Jugore; Letër nga Mary Edith Durham drejtuar Nolit; Komunikatë e Divizionit për Çështjet e Evropës Jugore drejtuar Departamentit të Shtetit lidhur me letrën e Dr. Omer Nishanit; Letër e Dr. Omer Nishanit drejtuar Konstantin Çekrezit; Deklaratë nga Grupi i Shqiptarëve të Mirë-Informuar Detroit drejtuar Drejtorit të Zyrës së Informatave Luftarake Uashington; Telegram nga përfaqësuesit e Kishës Ortodokse Shqiptare në Amerikë që duhej t’i dërgohej krerëve të SHBA, MB dhe BRSS; Letër nga Departamenti i Shtetit Amerikan drejtuar Nolit.

Në kapitullin e pestë **“Çështja e njohjes së Qeverisë së Enver Hoxhës dhe anëtarësimit të Shqipërisë në Kombet e Bashkuara (1945-1946)”**, autorët paraqesin këto dokumente: Letër nga Ambasada Britanike Uashington drejtuar Nolit; Letër nga Sekretari i Presidentit, Shtëpia e Bardhë Uashington, drejtuar Nolit; Telegram nga Konstantin Çekrezi; Letër nga Departamenti i Shtetit Amerikan Sektori për Shërbimet Telekomunikuese drejtuar Nolit; Letër nga Charles C. Hart drejtuar Nolit; Telegram nga Noli drejtuar Hysni Kapos, Legata Shqiptare Beograd; Memorandum “Shqipëria Pas Vitit 1939” nga [Dr. Latsey dhe grupi shqiptar drejtuar Delegacionit të Shteteve të Bashkuara pranë Organizatës së Kombeve të Bashkuara Nju Jork]; Letër nga Herschel V. Johnson, Delegacioni i SHBA-së pranë OKB-së, drejtuar Dr. Latsey; Bashkëngjitja e Pusullës së 10 dhjetorit 1945 e Departamenti të Shtetit dërguar Enver Hoxhës lidhur me çështjen e njohjes së regjimit të Shqipërisë.

Dokumentet përmbajnë shkresa, dorëshkrime, memorandume, raporte diplomatike, telegrame, si dhe letra korrespondence me karakter politik e diplomatik. Ato sjellin analiza e sinteza kritike, përfundime induktive dhe deduktive, qartësime dhe rezyme mbi ngjarje të kohës. Në to përfshihen edhe letra të diplomatëve amerikanë e britanikë, midis tyre mbështetës të vazhdueshëm të pavarësisë së shqiptarëve, si dhe personalitete të tjera kombëtare e ndërkombëtare që u angazhuan me përkushtim për zgjidhjen e

drejtë të çështjes shqiptare. Memorandumet dhe raportet diplomatike nga institucione të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Britanisë së Madhe, shpalosin aktivitetin e personazheve kryesore të politikës shqiptare, si: Fan S. Noli, Faik Konica, Kostandin Çekrezi, Kostandin-Koço Tashko, Ahmet Zogu, Tajar Zavalani, Anton Logoreci etj., që vinin nga shkolla të ndryshme dhe kishin dallime të mendimit politik.

Në mënyrë specifike, dokumentet janë dëshmi e artit të shkrimit dhe oratorisë së Fan S. Nolit, pasqyrojnë stilin e mendimit dhe rrjedhshmërinë e gjuhës, ku besimi dhe betimi ndaj Shqipërisë e shqiptarëve ishin drejtimi kryesor politik e ideologjik i tij. Në tërësi, përmes këtyre dokumenteve historike shpalosen segmente të caktuara të veprimtarisë politike dhe diplomatike të Fan S. Nolit dhe të emigracionit politik shqiptar në SHBA. Ato ndriçojnë dhe konstruktojnë ngjarje, dukuri dhe personalitete të jetës politike dhe diplomatike shqiptare. Prandaj, për sa më sipër, libri “*Nga thesari historik e kulturor i Fan Nolit - Shkresa, memorandume, Raporte Diplomatike dhe Korrespondencë 1927-1946*”, është kontribut i rëndësishëm në kolanën e dokumenteve të botuara në fushën e historiografisë shqiptare për shekullin XX.

Fitim RIFATI